



KRYETARE

**Barazia gjinore në procesin zgjedhor
– liria e votës dhe votimi familjar**

Peshkopi, 1 shtator 2016

Të nderuara Zonja,

Ndihem shumë e nderuar që jam këtu më ju sot për të bashkëbiseduar lidhur me rolin e rëndësishëm të gruas në një proces zgjedhor.

Së pari, më lejoni të shpreh falenderimet për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, një nga organizatat partnere më të rëndësishme të KQZ-së, që na ka mbështetur vazhdimisht në punën tonë, e veçanërisht në fushën e edukimit zgjedhor të votuesve, njërit prej aspekteve më të rëndësishme për rritjen e standarteve të procesit zgjedhor.

Pas 10 ditësh në Bashkinë tuaj do të zhvillohen zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë. Dita e zgjedhjeve, përtej rëndësisë që ka për kandidatët të cilët po zhvillojnë fushat e

tyre, është e një rëndësie të veçantë për votuesit, të cilët ushtrojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të zgjedhur, dhe dëshmojnë përmes pjesëmarrjes në votime, kontributin e tyre për zhvillimin e demokracisë.

Në zgjedhjet e vitit 2015 në Bashkinë Dibër, nga 27 332 femra të rregjistruara në listën e zgjedhëseve, vetëm 14 408 votuan.

12 924 zgjedhëse nuk folën me votën e tyre! Ne nuk mund ti dimë arsyet pse ato heshtën, pse ato nuk zgjodhën, pse ato nuk ushtruan të drejtën e tyre themelore kushtetuese, pse ato nuk treguan përgjegjshmëri për të ardhmen e tyre dhe të familjeve të tyre! Ajo që mund të themi me siguri është se ka arsye për këtë mungesë në votime: nuk ishin të ndërgjegjshme për vlerën e votës së tyre, nuk kishin informacionin e nevojshëm për të bërë zgjedhjen e tyre, nuk kishin besim se vota e tyre do të lexohej drejt, apo dikush i pengoi?!

Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë! Është detyrim qytetar i çdonjërës nga ne, që këtë garanci kushtetuese, njëherazi njërit prej parimeve kryesore të Kodit Zgjedhor, ta bëjmë lajtmotiv të bisedave dhe diskutimeve tona, sidomos në prag të zgjedhjeve, për të krijuar tek çdo grua që gëzon të drejtën e votës, besimin se çdo votë vlen, se çdo votë vendos, se çdo votë i shërben jo thjesht kandidatit apo partisë politike, por i shërben demokracisë!

Shkelja e të drejtës për zgjedhje të lirë dhe të drejtpërdrejtë më tepër përfshin grupet e prekura dhe të marginalizuara, si dhe gratë në mjediset rurale. Tradita maskiliste që forcon stereotipat gjinorë të ndeshur në fusha të ndryshme të jetës private e publike pengon veçanërisht gruan në këto zona të avancojë në realizimin ‘de facto’ të të drejtave të saj. Të detyruar të pranojnë të drejtën e gruas për të votuar, burrat në zona rurale, por jo vetëm, nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për të vendosur.

Gratë e ndërgjegjësjësura për fuqinë e votës së tyre, të cilat votojnë në mënyrë të lirë dhe të pandikuar nga mendimi i familjarëve të tyre, rrisin rolin e gruas në vendimarrje, bëhen barrierë për fenomenin negativ të “votimit familjar”, i cili për fat të keq vijon të shfaqet duke dhunuar të drejtat e grave, dhe duke u bërë shkas për cënimin e standarteve të procesit zgjedhor. Raportet e OSBE/ODIHR-it referojnë si raste të votimit familjar “shkuarjen e burrit dhe të gruas së bashku në dhomën e fshehtësisë në qendrën e votimit” por unë do të theksoja se ky fenomen negativ në ditët e sotme, po shfaqet si ndikim i vullnetit për të zgjedhur me votë, brenda mureve të shtëpisë. Shfaqja e këtij fenomeni negativ në një formë të sofistikuar kërkon angazhimin maksimal të të gjithë gjithë shoqërisë por mbi të gjitha të vetë në grave për ta luftuar atë.

Në një proces zgjedhor, përfshirja dhe roli i gruas jo vetëm si votuese, por edhe si komisionere zgjedhore, është tregues i shkallës së emancipimit të shoqërisë. Në kontekstin shqiptar, barazia reale gjinore në procesin zgjedhor, ashtu si në të gjithë aspektet e tjera të jetës

sociale e politike, është gjithashtu një nga faktorët apo levat më të rëndësishme për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Përmirësimet e ligjit zgjedhor, e kanë fuqizuar rolin e gruas në kandidim dhe në angazhimin si komisionere, por ende ka shumë për t'u bërë. Falë kuotave gjinore të përmirësuara, por edhe ndërgjegjësimit shoqëror, sot kemi më shumë deputete në Kuvend, më shumë Kryetare të Bashkive, më shumë anëtare të këshillave bashkiakë, më shumë komisionere të KZAZ-ve. Por mungesa e kuotës gjinore për komisionet e Qendrave të Votimit, bën që për zgjedhjet e 11 shtatorit në Bashkinë Dibër, nga 826 komisionerë të propozuar nga partitë politike, vetëm 14 ose 1.7% e tyre, të jenë femra. Referova komisionet në Dibër, për shkak të aktualitetit, por edhe në proceset e tjera zgjedhore në rang vendi, situata nuk është shumë e ndryshme. Vlerësoj se, rritja e përfaqësimit të grave në komisionet e qendrave të votimit, përmbush jo vetëm detyrimin ligjor të përcaktuar në “Ligjin për barazinë gjinore në shoqëri”, por është mënyra më e mirë për të

luftuar fenomenin negativ të votimit familjar. Gratë komisionere janë garanci më shumë për respektimin e votës së fshehtë dhe të lirë të grave!

Zgjedhjet demokratike karakterizohen nga gara paqësore politike, ku partitë politike dhe kandidatët synojnë të nxjerrin në pah dallimet që kanë me kundërshtarët e tyre dhe kjo mund të përfshijë dhe komente kritike dhe negative. Përfshirja më e madhe e grave në procesin zgjedhor, padyshim do të ndikonte në qetësimin e klimës zgjedhore.

Unë besoj, se forcat politike që garojnë për këto zgjedhje, kanë maturimin dhe përvojën disa vjeçare për të ndikuar me sjelljen e tyre në klimën e përgjithshme pragzgjedhore, klimë e cila duhet të karakterizohet nga qytetaria dhe vlerat demokratike, për të forcuar besimin e votuesve dibranë tek procesi zgjedhor!

Jam e bindur, se bashkëbisedimin dhe diskutimet tona gjatë këtij takimi, ndarjen e eksperiencave qoftë dhe personale, do ta përcillni dhe do të ndikoni që votueset dibrane në 11 shtator, t'i drejtohen qendrave të votimit dhe të bëjnë zgjedhjen e tyre me votë të lirë, të fshehtë dhe të pandikuar!

Ju faleminderit!